



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 948/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjorë Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtruar nga Premtim Fazliu, nga subjekti politik Alternativa, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuar apelet e parashtruara nga Premtim Fazliu, nga subjekti politik Alternativa, me seli në Prishtinë, me shenjen ZL.Anr.948/2017 dhe ZL.Anr.952/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar dy apele ZL.Anr.948/2017 dhe ZL.Anr.952/2017 me datë 10.11.2017 në ora 11:30, nga Premtim Fazliu, nga subjekti politik Alternativa, me seli në Prishtinë. Në apelin ZL.Anr.948/2017 parashtruesi i apelit thekson se është bërë numërimi i gabuar i përgjithshëm i votave të subjektit politik Alternativa në Prishtinë duke kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave të kandidatëve të këtij subjekti politik për të gjitha kutit e votimit për komunën e Prishtinës. Në apelin ZL.Anr.952/2017 parashtruesi i apelit pretendon se në vendvotimet 1960E.01R; 1960E/02R si dhe në qendrën e votimit 1910E dhe 1922E duke i përfshirë edhe vendvotimet 01R/02R/03/04R i njëjti thekson se ka më shumë vota nga ato të cilat i ka publikuar KQZ-ja.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar apelet dhe i ka trajtuar si një apel të evidentuar me ZL Anr. 948/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të dy apelet vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pabazuara

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apeleve nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe nuk e ka dëshmuar me asnjë provë krahasueshmërinë e votave për të cilat pretendon se i mungojnë.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara për shkak të mungesës së dëshmive lidhur me pretendimet e parashtruara në apele dhe se të njëjtat nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apele, konstaton se apelet në fjalë janë të pa argumentuar me fakte dhe si i tilla janë të pabazuara.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.948/2017 më datën 12.11.2017.



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*